



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:228400
Datë: 14.06.2022
Numri i dokumentit: 03307389

C.nr.1013/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Divizioni Civil, gjyqtari **Betim Behluli**, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike të paditësve Sh. Z. nga Gjakova, Rr. “S.” p.n., A. (A.) M., A. (Z.) M., të dytë nga Peja, Rr. “Zh. S.”, p.n, të cilët i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “N. & A.” me seli në Pejë, kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Rr. “Ish Ndërtesa e Gërmisë”, 10000, Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar N. K. sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jo material, vlera e kontestit **36,256.20 €**, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor, dhe zbatimit të provave, më **02.06.2022**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Pjesërisht aprovohet** kërkesëpadia e paditësve **Sh. Z., A. (A.) M., A. (Z.) M.**, si në vijim:
- II. Obligohet** e paditura **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**, që paditësit **Sh. Z.**, në emër të dëmit material në automjetin i tipit “Range Rover”, me targa ...-...-..., që ka pësuar në aksidentin e trafikut të datës 19.12.2020, të i kompensojë shumën prej **19,256.20 €**, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 11.10.2021 e gjerë te pagesa definitive, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
- III. Obligohet** e paditura **Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**, që paditësit **A. A. M.**, në emër të dëmit jo material dhe material të kompensoj:
 - Në emër të dhimbjeve fizike.....**800,00 €.**
 - Në emër të frikës së përjetuar.....**800,00 €**, me kamat ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit respektivisht nga data 02.06.2022, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
 - Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj.....**300,00 Euro.**
 - Në emër të ushqimit të përforcuar.....**200,00 Euro**, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 11.10.2021 e gjerë te pagesa definitive, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
- IV. Obligohet** e paditura *Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës*, që paditësit **A. A. M.**, në emër të dëmit jo material dhe material të kompensoj:
 - Në emër të dhimbjeve fizike.....**800,00 €.**

- Në emër të frikës së përjetuar.....**800,00 €**, me kamat ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit respektivisht nga data 02.06.2022, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.
- Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj.....**300,00 Euro**.
- Në emër të ushqimit të përforcuar.....**200,00 Euro**, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 11.10.2021 e gjerë te pagesa definitive, dhe atë në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

V. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së precizuar përtej shumës së aprovuar.

VI. OBLIGOHET e paditura që paditësve ti paguaj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej **4,648.80 €**, po ashtu në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësit Sh. Z., A. (A.) M., A. (Z.) M. përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, kanë ushtruar padi kundër të paditurës Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për shkak të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial.

E paditura Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, me parashtrësën e saj përgjigje në padi e ka kontestuar kompetencën territoriale sepse Ministria e ka selinë në Prishtinë si palë e paditur.

Sipas kësaj çështje juridike janë caktuar disa seanca e shqyrtimin kryesor radhazi, në të cilën janë paraqitur përfaqësuesi i autorizuar i paditësve avokati A. N. si dhe P. Zh. ndërsa për të paditurën përfaqësuesi i autorizuar N. K..

Përfaqësuesja e të paditurës avokate Pranvera Zharra ka deklaruar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së saj. E paditura me parashtrësën e datës 28.12.2021, e ka kundërshtuar kompetencën lëndore të Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, përkitazi me gjykimin dhe vendosjen e çështjes për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial sipas padisë së paditësve Sh. Z., A. M. dhe A. M.. E autorizuar e paditësve ashtu siç ka theksuar në parashtrësën e datës 25.02.2022, rithekson në këtë seancë se kundërshton të gjitha pretendimet e të paditurës që kanë të bëjnë me kompetencën lëndore dhe territoriale lidhur me këtë çështje kontestimore dhe atë duke u mbështetur në nenin 47 paragrafi 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, citoj: “Për gjykim në kontestet lidhur me përgjegjësinë jo kontraktuale për dëmin përveç gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilën është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit”. Lidhur me vërtetimin e kërkesëpadisë i propozoi gjykatës që për seancën e radhës të ftohen ekspertët mjekësor një nga lëmia e ortopedisë dhe një tjetër nga lëmia e psikiatrisë, të cilët me anë të mendimit profesional do të deklarohen për lëndimet trupore të cilat i kanë pësuar ditën kritike paditësi A. M. dhe A. M.. I kundërshtoi në tërësi të gjitha pretendimet e të autorizuarit të të paditurës i cili kërkoi nga gjykata që në seancën e radhës të ftohet eksperti B. K. pasi që konsideron se ekspertiza e cila është punuar me shkrim është mjaft e qartë dhe gjithashtu i përgjigjet gjendjes reale faktike. Gjithashtu e kundërshtoi edhe pretendimin se mungon baza juridike e kërkesëpadisë për faktin se Ministria e Infrastrukturës, Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për mirëmbajtjen e rrugës R 107 Prizren – Gjakovë, sipas përgjegjësiave të përcaktuara në nenin 8 dhe 12 të Ligjit nr.2003/11 Ligjit për rrugët si dhe nenit 6 dhe 9 të ligjit

nr.03 L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët. Mbi këtë bazë konstatojmë se përgjegjëse për kompensimin e dëmit sipas padisë së paditësve është e paditura pra Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. I propozoj gjykatës që ta refuzoj propozimin e të autorizuarit të të paditurës.

Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e autorizuar e paditësve, me rastin e parashtrimit të padisë e ka marrë parasysh përgjegjësinë objektive të të paditurës, e cila nënkupton që për mbrojtjen e të drejtave personale dhe pasurore të qytetarëve është e domosdoshme që të ekzistoj përgjegjësia për dëmin në bazë të vet faktit se dëmi është shkaktuar nga sendi që krijon rrezik të shtuar për rrethin. Ditën kritike me datë 24.06.2021, rreth orës 17:45, në fshatin Celinë, Komuna e Rahovecit, drejtuesi i automjetit A. M., përderisa ishte duke lëviz me veturë, papritmas rrëzohet një lis në skaj të rrugës kryesore dhe i bie mbi veturë, me ç'rast i shkakton dëme të konsiderueshme materiale në automjet si dhe lëndime trupore pëson drejtuesi i automjetit si dhe babai i tij A. M., i cili ishte bashkudhëtarë në veturë. Në rastin konkret përgjegjësia për kompensimin e dëmit bie mbi Ministrinë e Infrastrukturës tani Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, sepse është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugës R107 Prizren - Gjakovë, rrugë në të cilën ka ndodhur aksidenti dhe sipas përgjegjësive të përcaktuara me nenin 8 dhe 12 të Ligjit Nr. 2003/ 11 Ligji për Rrugët dhe nenit 6 dhe 9 të Ligjit Nr. 03/ L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Rrugë Nr. 2003/11. Pas vërtetimit të përgjegjësive, kërkesa për zhdëmtim është bazuar në: Neni 179 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, citoi: "Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fit-imin e humbur për shkak të paafësisë për punë gjatë kohës së mjekimit, dhe Nenin 183 paragrafi 1 i po të njëjtit ligj përcakton se : "Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Lartësia e kërkesëpadisë për paditësit A. A. M. dhe A. Z. M., është vërtetuar me nxjerren e ekspertizave nga lëmia e mjekësisë, ku ekspertët nga lëmia e ortopedisë dhe e psikiatrisë me anë të mendimit profesional bazuar në shkresat e lëndës dhe ekzaminimit të palëve kanë konstatuar se paditësit A. M. dhe A. M., kanë pësuar lëndime trupore. Lartësia e dëmit material në automjet në emër të paditësit të parë Sh. Z., është vërtetuar me ekspertizën nga lëmia e makinerisë e cila është punuar nga eksperti B. K.. Andaj nga sa u tha më lartë, i propozohet gjykatës që padinë e paditësve t'a miratoj në tërësi dhe atë në kuptim të precizimit të kërkesëpadisë të bërë me parashtrësën e datës 07.06.2022. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumë prej 4,648.80 €.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës N. K. ka deklaruar se e kundërshtojnë në tërësi padinë dhe kërkesën e saj gjithashtu sipas pretendimeve të tyre çështjen e kompetencës territoriale duhet të vendoset nga gjykata para shqyrtimit të mëtutjeshëm të kësaj lënde sepse sipas mendimit tonë kompetenca e përgjithshme është sipas selisë së të paditurit për gjykatën konfirmojnë se e kanë pranuar ekspertizën e aksidentit të trafikut rrugor të B. K. si dhe ekspertizën e vlerësimit të dëmit përsëri të B. K. mendon për sqarimit të çështjes është e nevojshme që eksperti për aksidentit rrugor dhe vlerësimin e dëmit mundësisht në një seancë të dëgjohet me gjithë se ekspertizat ka vlerësuar se si pasojë e rrëzimit të një peme është shkaktuar aksidenti gjykata duhet të ketë parasysh që zakonisht që Ministria kontraktkon ndërmarrjen për mirëmbajtjen e rrugëve, së dyti sipas ekspertit mendojnë që gjykata përsëri duhet ketë parasysh rrëzimi i pemës është një ngjarje e pa parashikuar dhe mund të lidhjet edhe me një fuqi madhore

vismajor pasi që ngjarja ka qenë e pa parashikuar mbi këto baza ne mendojnë që kërkesëpadia duhet të refuzohet si e pa bazuar dhe të njëjtën kohë e kundërshtojmë për ekspertizat mjekësore.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka zbatuar këto provat: ka bërë shikimin në raportin policor nr.2020-ER-381, i datës 29.06.2021, ka bërë shikimin në fotografitë e veturës së dëmtuar, ka bërë shikimin në ekspertizën e komunikacionit i datës 21.08.2021, ka bërë shikimin në ekspertizën e makinerisë e datës 21.08.2021, ka bërë shikimin në raportin e emergjencës nr.10045 i datës 24.06.2021, të lëshuar nga Spitali “Isa Grezda” në Gjakovë, ka bërë shikimin në raportin e emergjencës nr.10607, i datës 24.06.2021, të lëshuar nga Spitali Regjional në Pejë, ka bërë shikimin në raportet nga konsultat mjekësore të datës 02.07.2021, të datës 30.06.2021, të datës 24.06.2021, ka bërë shikimin në raportin e emergjencës nr.10044, i datës 24.06.2021, të lëshuar nga Spitali “Isa Grezda” në Gjakovë, ka bërë shikimin në raportin e emergjencës nr.10608, i datës 24.06.2021, të lëshuar nga Spitali Regjional në Pejë, ka bërë shikimin në konsultat mjekësore të datës 02.07.2021, të datës 30.06.2021, 24.06.2021, 30.06.2021, ka bërë shikimin në ekspertizën e ekspertëve mjekësor Dr. Xh. S. dhe Dr. V. B. e datës 30.05.2022.

Pas analizimit dhe vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në dispozitat të neneve 7 dhe 8 të LPK-së, duke i vlerësuar deklaratimet e ndërgjyqësve dhe në bazë të bindjes së vetë të lirë, është konstatuar se kërkesëpadia e paditësve është e pjesërisht e bazuar, ndërsa pjesën tjetër e ka refuzuar.

Nga provat e administruara është vërtetuar se me datë 2020-ER-381, i datës 29.06.2021, në fshatin Celinë, Komuna e Rahovecit, është rrëzuar një lis në skaj të rrugës kryesore dhe i bie mbi veturë, me ç’rast i shkakton dëme materiale në automjet si dhe lëndime trupore drejtuesit të automjetit A. M., si dhe babait të tij A. M., i cili ishte bashkudhëtar në veturë.

Me shikimin në fotografitë e veturës vërtetohet dëmi i shkaktuar.

Me shikimin në ekspertizën për vlerësimin e dëmit në automjet të ekspertit B. K., të datës 21.08.2021, vërtetohet se vlera totale e dëmit të shkaktuar si pasoj e aksidentit, vlerësuar si “Dëm i Riparueshëm” është: $V = 19,256.20$ Euro.

Me shikimin në raportet e emergjencës të lëshuar nga Spitali “Isa Grezda” në Gjakovë, nga Spitali Regjional në Pejë, si dhe dokumente tjera vërtetohet se paditësit A. M. dhe A. M. janë trajtuar në Emergjencë.

Pas ekzaminimit të palëve paditësve dhe me pëlqimin e ndërgjyqësve përfaqësueses së autorizuar të paditësve, eksperti i mjekësisë Dr. Xh. S. ortoped-traumatolog si dhe ekspertja mjekësore Dr. V. R. psikiatre, kanë deklaruar se ekspertizën respektivisht raportin dhe mendimin e tyre, ku kanë konstatuar se:

Paditësi A. M. ka pësuar lëndime të lehta trupore si: ndrydhje e kokës, qafës dhe trupit e shoqëruar me gërvishje të të dy këcinjëve. Dhembjet fizike me intensitetit posaçërisht të rëndë: 15 minuta, të intensitetit të rëndë: 24 orë, të intensitetit mesatar: 14 ditë, të intensitetit të ulët: sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin ai ankon për dhimbje të herë pas hershme të cilat janë më të shprehura në ndryshime klimatike. Frikë dhe intensitet të frikës ka pasur dhe atë frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 24 orë. Frika sekondare të intensitetit të mesëm ka zgjatur 6 javë. Frika sekondare të intensitetit të ulur vazhdon ende herë pas here sidomos në situata të ngashme me atë të aksidentit, duke e bërë të ndien shqetësim dhe pasiguri. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor - nuk ka, shëmtim

trupor - nuk ka, Ndihma e huaj: ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 14 ditëve. Ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshme prej 21 ditësh. Rehabilitimi klimatik dhe fizioterapeotik: ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh brenda vitit të parë pas aksidentit.

Paditësi A. M. ka pësuar lëndime të lehta trupore si: ndrydhje e kokës, qafës dhe trupit, ndrydhje e anës së djathtë të krahërorit. Dhembjet fizike me intensitetit posaçërisht të rëndë: 15 minuta, të intensitetit të rëndë: 24 orë, kohë pas kohe deri e marrjes së terapisë kundër dhimbjes, të intensitetit mesatar: 14 ditë, të intensitetit të ulët: sipas të dhënave nga bashkëbisedimi me paditësin ai ankon për dhimbje të qafës dhe krahut të majtë, të cilat janë më të shprehura në pozitë detyruese (ulur) si dhe në ndryshime klimatike dhe sforcime fizike. Frikë dhe intensitet të frikës ka pasur dhe atë frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda. Frika sekondare e intensitetit të lartë ka zgjatur 24 orë. Frika sekondare të intensitetit të mesëm ka zgjatur 6 javë. Frika sekondare të intensitetit të ulur vazhdon ende herë pas here sidomos në situata të ngashme me atë të aksidentit, duke e bërë të ndien shqetësim dhe pasiguri. Zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor - nuk ka, shëmtim trupor - nuk ka, Ndihma e huaj: ka qenë e nevojshme në kohëzgjatje prej 14 ditëve. Ushqim i përforcuar ka qenë i nevojshme prej 21 ditësh. Rehabilitimi klimatik dhe fizioterapeotik: ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 10 ditësh brenda vitit të parë pas aksidentit.

Sipas dispozitës së nenit 136 të LMD-së, parashihet se: kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa neni 140 e të njëjtit ligj parasheh se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia, ndërsa në nenin 199.1 parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit.*

Për lartësinë dhe kategoritë të caktuara të dëmit jo material gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitat të nenit 177.2 dhe 183 të LMD-së, e lidhur me nenin 323 të LPK-së, e në këtë rast gjykata ka pas parasysh që janë shkëlur dhe me qëllim për të cilin shërben kompensimi i gjykuar duke pasur gjithmonë kompensimi të jetë satisfaksion për paditësit dhe shumat që janë cekur në dispozitiv të aktgjykimit i ka bazuar në dispozitat ligjore, praktikën gjyqësore si në kriteret të kompanive që aplikohen për kompensimin e dëmeve në aksident të trafikut, kurse lidhur me kamatën është mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u bazuar në dispozita të neneve 136, 140, 159, 177 dhe 183 të LMD-së, vlerëson se e paditura është përgjegjëse për dëmin e shkaktuar paditësve sepse është përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugës R107 Prizren - Gjakovë, rrugë në të cilën ka ndodhur dëmi dhe sipas përgjegjësisë të përcaktuara me nenin 8 dhe 12 të Ligjit Nr. 2003/ 11 Ligji për Rrugët dhe nenit 6 dhe 9 të Ligjit Nr. 03/ L-120 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Rrugë Nr. 2003/11, dhe duke u mbështetur në dispozitat e neneve 143, 323, dhe 390 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale gjykata është mbështetur në dispozitat e neneve 449 dhe 452 të LPK-së, ashtu që janë të detyruar të paditurat që të kompensojnë shpenzimet që i referohen përfaqësuesit të palës paditëse atë për taksën për padi 104,00 €, për përpilimin e padisë shumë prej 416,00 €, propozimi për sigurimin e provave 416,00 €, taksa gjyqësore për propozimin për sigurimin e provave 31,00 €, për 1 seancë të mbajtur në terren për sigurim të provave 540,80 €, për 3 seanca gjyqësore në shumë prej 3*540,80 = 1,622.40 euro, mbyllja e zyrës për 4 seanca të mbajtura (1,622.40 x 25 %) 405,60 €, kompensimi për ekspertin nga lëmia

e komunikacionit 100,00 €, kompensimi për ekspertin nga lëmia e makinerisë 100,00 €, kompensimi i ekspertit të mjekësisë nga ortopedia 250,00 €, kompensimi i ekspertit të mjekësisë nga psikiatria 250,00 €, precizimi i kërkesëpadisë 416,00 €, ku totali i shpenzimeve është 4,648.80 €.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
C.nr.1013/2021, më datë 02.06.2022

B. Profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.